**VENDIM**
**Nr.990, datë 10.12.2010**

**PËR KALIM FONDI NGA MINISTRIA E DREJTËSISË TEK OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondi prej 13 828 334 (trembëdhjetë milionë e tetëqind e njëzet e tetë mijë e treqind e tridhjetë e katër) lekësh, parashikuar në buxhetin e vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Drejtësisë, në programin "Sistemi i burgjeve", zëri "Fonde për përballimin e kostove lokale për investimet e huaja", të transferohet në llogarinë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe të përdoret prej tij për zhvendosjen e linjës së tensionit të lartë, e cila siguron vazhdimin e punimeve për ndërtimin e tri godinave të regjimit të jashtëm të paraburgimit të Elbasanit.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë dhe Operatori i Sistemit të Transmetimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**